



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna- Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	23-06-2026
REFERENC-Ë:	02-400/01-0035990/26
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit
KOPJE :	Arkivit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Faton Peci - Kryetari i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pasqepzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026

Të nderuar/a,

Organizata buxhetore (642) – Komuna e Mitrovicës, në zbatim të LIGJI NR. 10/L-001 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2026, bilancet e pasqepzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2026 sipas autorizimeve të LMFPF-së.

Andaj me këtë shkresë kërkojmë nga **Komiteti për Politikë dhe Financa** që të bëhet aprovimi i bartjes së të hyrave vetanake në vlerë totale 1,229,593.36 euro

- Kategorinë e shpenzimeve Paga dhe Shtesa, në programet/nënprogramet:
 - Shërbimet e Shëndetësisë Primare (74300) në vlerë 70,593.36 euro**TOTALI në kategorine Paga dhe Shtesa 70,593.36 euro.**
- Kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime, në programet/nënprogramet:
 - Planifikimi i Zhvillimi Ekonomik (48022) në vlerë 750,000.00 euro;
 - Inspektive (16643) në vlerë 50,000.00 euro;
 - Menaxhimi i katastrofave natyrore (18466) në vlerë 30,000.00 euro dhe
 - Zyra e Kuvendit (16922) në vlerë 20,000.00 euro
 - Arsimi Parafillor (92630) në vlerë 34,000.00 euro**TOTALI në kategorine Mallra dhe Shërbime 884,000.00 euro.**
- Kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, në nënprogramet:
 - Administrata e Përgjithshme (16322), në vlerë 75,000.00 euro dhe
 - Shërbimet Kulturore (85022), në vlerë 80,000.00 euro.
 - Bujqësia (47022), në vlerë 70,000.00 euro
 - Shërbimet Sociale (75606), në vlerë 50,000.00 euro**TOTALI në kategorine Subvencione dhe Transfere 275,000.00 euro**

Arsyetimi:

Ne zbatim te pikës 1 për kategorinë ekonomike **Paga dhe Shtesa** gjeni arsyetimin si në vijim;

- a. Në zbatim të Ncni 6 te Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Neni 21 i Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, ku të hyrat në këtë sektor duhet të destinohen po në këtë sektor;

Ne zbatim te pikës 2 për kategorinë ekonomike **Mallra dhe Sherbime** gjeni arsyetimin si në vijim:

a) Planifikimi i Zhvillimi Ekonomik (48022) në vlerë 750,000.00 euro

1. **Hartimi i projekteve** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **76,000.00 euro**, me qëllim të nënshkrimit të kontratës për hartimin e projekteve. Kjo kontratë është e domosdoshme për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe procedimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit publik.
2. **Trajtimi i qenve endacakë në Komunën e Mitrovicës** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **100,000.00 euro**, për realizimin e trajtimit human të qenve endacakë dhe garantimin e sigurisë publike, në përputhje me obligimet ligjore dhe standardet për mbrojtjen e kafshëve.
3. **Mirëmbajtja e ndriçimit publik** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **100,000.00 euro**, me qëllim të plotësimit të planifikimit buxhetor dhe realizimit të mirëmbajtjes dhe rregullimit të sistemit të ndriçimit publik, duke kontribuar në rritjen e sigurisë në rrugët lokale dhe hapësirat publike.
4. **Mirëmbajtja verore e rrugëve** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **150,000.00 euro**, për realizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes verore, me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacion dhe zgjatjes së jetëgjatësisë së infrastrukturës rrugore.
5. **Larja dhe fshirja e rrugëve** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **120,000.00 euro**, për kryerjen e shërbimeve të pastrimit, fshirjes dhe larjes së rrugëve, me qëllim të përmirësimit të pastërtisë publike, mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe mirëmbajtjes së mjedisit urban.
6. **Riparimi dhe rregullimi i rrugëve dhe shesheve** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **120,000.00 euro**, për rregullimin e dëmtimeve në rrugë, trotuare dhe sheshe publike, duke përmirësuar infrastrukturën komunale dhe sigurinë e pjesëmarrësve në komunikacion.
7. **Sinjalizimi rrugor** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **84,000.00 euro**, për plotësimin e planifikimit buxhetor dhe realizimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët lokale, me qëllim të rritjes së sigurisë në trafik dhe përmbushjes së obligimeve ligjore në fushën e komunikacionit rrugor.

b) Inspektimi (16643) në vlerë 50,000.00 euro

1. **Rrënimi i objekteve pa leje në Komunën e Mitrovicës** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **50,000.00 euro**, me qëllim të inicimit të procedurës së prokurimit publik për lidhjen e një kontrate trevjeçare për rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje. Kjo kontratë është e nevojshme për zbatimin e vendimeve të organeve kompetente dhe forcimin e rendit urbanistik në territorin e Komunës së Mitrovicës.

c) Menaxhimi i katastrofave natyrore (18466) në vlerë 30,000.00 euro

1. **Berja e pajisjeve për nevojat e Njësisë së Zjarrfikësve** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **30,000.00 euro**, me qëllim të inicimit të procedurës së prokurimit publik për furnizimin me pajisje të domosdoshme për Njësinë e Zjarrfikësve në Mitrovicë. Sigurimi i këtyre pajisjeve do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve operacionale, lehtësimin e punës së zjarrfikësve gjatë intervenimeve dhe përmirësimin e efikasitetit në fikjen e zjarreve dhe menaxhimin e situatave emergjente.

d) Zyra e Kuvendit (16922) në vlerë 20,000.00 euro

1. Kostoja totale për zbatimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0021467-4/26 për kompensimin e anëtarëve të Komiteteve Konsultative, komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc, për këtë vit (2026) llogaritet të jetë rreth 20,000.00 €;

e) Arsimi Parafillor (92630) në vlerë 34,000.00 euro

1. Në zbatim të Nenit 6 të Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Neni 21 i Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, ku të hyrat në këtë sektor duhet të destinohen po në këtë sektor;

Ne zbatim të pikës 3 për kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere gjëni arsyetimin si në vijim:

a) Administrata e Përgjithshme (16322), në vlerë 75,000.00 euro

1. **Rritja e numrit të bursave dhe e vlerës financiare për studentët** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **75,000.00 euro**, me qëllim të realizimit të pagesës së bursave për studentët përfitues sipas shpalljes publike të Komunës së Mitrovicës. Sigurimi i këtyre mjeteve do të mundësojë mbështetjen financiare të studentëve, rritjen e mundësive për arsimim cilësor dhe përmbushjen e obligimeve të Komunës ndaj përfituesve të bursave.

b) Shërbimet Kulturore (85022), në vlerë 80,000.00 euro

1. **Rritja e përkrahjes për sektorin e sportit** – Nevojiten mjete shtesë në vlerë prej **80,000.00 euro**, me qëllim të realizimit të thirrjes publike për mbështetjen financiare të klubeve sportive në qytetin e Mitrovicës. Sigurimi i këtyre mjeteve do të mundësojë përkrahjen e aktiviteteve sportive, zhvillimin e klubeve dhe promovimin e sportit, duke kontribuar në përfshirjen e të rinjve në aktivitete sportive dhe në avancimin e jetës sportive në komunë.

c) Bujqësia (47022), në vlerë 70,000.00 euro

1. **Rritja e përkrahjes për fermerët dhe bujqit** – Është planifikuar një **rritje e buxhetit në vlerë prej 70,000.00 euro** krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2026, me qëllim të zgjerimit të mbështetjes për sektorin e bujqësisë. Këto mjete do të shërbejnë për përmirësimin e kushteve të punës së fermerëve, rritjen e produktivitetit dhe rendimentit në veprimtarinë bujqësore, si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në Komunën e Mitrovicës.

d) Shërbimet Sociale (75606), në vlerë 50,000.00 euro

1. **Mbulimi i shpenzimeve të varrimit për qytetarët** – Nënshkrimi i kontratës së re për ofrimin e shërbimeve të varrimit ka krijuar kosto shtesë në mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Mitrovicës. Për këtë arsye, është planifikuar një **rritje e mjeteve në vlerë prej 50,000.00 euro**, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së këtij shërbimi dhe përmbushjes së obligimeve financiare që rrjedhin nga kontrata, duke garantuar mbështetje për qytetarët në këto raste

Me respekt,

From: Behije Tahiri Mehulli
Sent: Monday, June 22, 2026 9:11 AM
To: Zenel Citaku
Cc: Gazmend Gjoshaj; Jeton M. Gashi; Mentor Ujkani; Sanela Sadikovic Kelmendi
Subject: RE: Kërkesë për plotësim/ndryshim të vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 ne 2026!

I nderuari Zenel,

Po ju përsërisë edhe një here e-mailin ku kemi kërkuar ndryshimin e vendimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe të dërgoni kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në 2026.

Me respekt;
Behija

From: Behije Tahiri Mehulli
Sent: Tuesday, June 16, 2026 2:55 PM
To: Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>
Cc: Gazmend Gjoshaj <Gazmend.Gjoshaj@rks-gov.net>; Jeton M. Gashi <Jeton.M.Gashi@rks-gov.net>; Mentor Ujkani <Mentor.Ujkani@rks-gov.net>
Subject: RE: Kërkesë për plotësim/ndryshim të vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 ne 2026!

I nderuari Zenel,

Pavarësisht ndihmesës nga Granti i Përgjithshëm për sektorin e arsimit dhe shëndetësie, të hyrat e realizuara nga këto dy sektorë sipas Nenit 6 të Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Neni 21 i Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, duhet të destinohen në këta sektorë.

Ju lutem duke u bazuar në e-mailin paraprak, të bëni ndryshimin e vendimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe të dërgoni kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në 2026.

Me respekt;
Behija

From: Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>
Sent: Tuesday, June 16, 2026 10:40 AM
To: Behije Tahiri Mehulli <Behije.Tahiri@rks-gov.net>
Cc: Gazmend Gjoshaj <Gazmend.Gjoshaj@rks-gov.net>; Jeton M. Gashi <Jeton.M.Gashi@rks-gov.net>; Mentor Ujkani <Mentor.Ujkani@rks-gov.net>
Subject: RE: Kërkesë për plotësim/ndryshim të vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 ne 2026!

E nderuar,

Duke ju falënderuar për analizën dhe gjetjet tuaja lidhur me kërkesën e Komunës sonë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026, ju njoftojmë si në vijim:

- Komuna e Mitrovicës, nga Granti i Përgjithshëm, ka mbështetur sektorin e Shëndetësisë gjatë gjithë vitit 2025, në përputhje me kërkesat dhe mundësitë buxhetore, duke tejkaluar shumën prej **2,081.00 euro**, e cila ka mbetur e papërfshirë në vendimin e Komunës për bartjen e të hyrave vetanake.
- Po ashtu, Komuna e Mitrovicës, nga Granti i Përgjithshëm, ka mbështetur sektorin e Arsimit gjatë gjithë vitit 2025, në përputhje me kërkesat dhe mundësitë buxhetore, duke tejkaluar shumën prej **33,339.89 euro**, e cila gjithashtu ka mbetur e papërfshirë në vendimin e Komunës për bartje.
- Totali i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës është **30.00 euro më i ulët** se vlera e paraqitur në raportin e pasqyrave financiare. Për këtë arsye, ju lutemi të vazhdoni me realizimin e kërkesës së Komunës sonë, ndërsa diferenca negative prej 30.00 euro të reflektohet në kategorinë ekonomike **Subvencione dhe Transfere**.

Për çdo kërkesë shtesë ose paqartësi, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,

From: Behije Tahiri Mehollli <Behije.Tahiri@rks-gov.net>

Sent: Monday, June 15, 2026 3:30 PM

To: Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>

Cc: Gazmend Gjoshaj <Gazmend.Gjoshaj@rks-gov.net>; Jeton M. Gashi <Jeton.M.Gashi@rks-gov.net>

Subject: Kërkesë për plotësim/ndryshim të vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 ne 2026!

I nderuari Zenel,

Ju njoftojmë se me datë 12.06.2026 kemi pranuar kërkesën e komunës tuaj për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në 2026. Deri në këtë fazë të analizimit të kërkesës tuaj duhet të korrigjohen disa çështje:

- Sipas raporteve të freebalancit të hyrat e realizuara në sektorin e shëndetësisë primare për vitin 2025 kanë qenë 32,081.50 €, kurse shpenzimi i të hyrave në këtë sektorë bazuar në raportet e freebalancit janë 30,000 €. Diferenca prej 2,081 € nuk është e destinuar në sektorin e shëndetësisë sipas Nenit 6 të Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Neni 21 i Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, ku të hyrat në këtë sektor duhet të destinohen po në këtë sektor;
- Sipas raporteve të freebalancit të hyrat e realizuara në arsimin para fillor dhe në arsimin e mesëm janë 146,298 €, kurse shpenzimi i të hyrave në këtë sektor sipas raporteve janë 112,958.11 €, diferenca prej 33,339.89 € nuk është e destinuar në sektorin e arsimit sipas Nenit 6 të Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Neni 21 i Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, ku të hyrat në këtë sektor duhet të destinohen po në këtë sektor;
- Totali i shumes për bartjen e të hyrave vetanake të paraqitur në vendimin e datës 29.04.2026, nuk përputhet me totalin e të hyrave vetanake për bartje të paraqitur në raportin e pasqyrave financiare;
- Të korrigjohet emërtimi i programi zhvillimi ekonomik në nën programin planifikimi i zhvillimit ekonomik.

Ju lutem të bëni ndryshimin e vendimit të kuvendit komunal me vërejtjet e paraqitura dhe pastaj të dërgohet kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake nga vitin 2025 ne vitin 2026.

Me respekt;



Behije Tahiri Mehollli

Analiste e Lartë e Buxhetit

Divizioni i Buxhetit Komunal/ Departamenti i Buxhetit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Niveli Lokal

Përshkrimi	Pranimet 2025-fondi 21 dhe tjera/	Pagesat 2025 - Fondi 21	Mjetet e pashpenzuara - nga fondi 21	Pranimet 2025 fondi 22	Pagesat Fondi -22	Mjetet e pashpenzuara - nga fondi 22	Të hyrat e depozituara në LVTH dhe të cilat nuk janë buxhetuar në SIMFK	Bartja në 2026
	a	b	c=a-b	d	e	f=d+e	g	h=c+f+g
Gillogoc	2,740,281	1,799,614	940,667	953,494	842,743	110,750	-	1,051,417.73
Fushë Kosovë	6,103,662	2,875,093	3,228,570	4,372,572	3,580,060	792,513	-	4,021,082.39
Liplian	3,911,817	2,344,405	1,567,412	1,389,651	1,320,444	69,208	-	1,636,619.98
Obiliq	1,882,484	1,498,034	384,450	201,565	201,565	-	-	384,449.70
Podujevë	2,801,287	1,446,195	1,355,092	890,001	804,650	85,352	-	1,440,443.17
Prishtinë	49,337,033	38,559,324	10,777,709	28,645,606	28,613,723	31,883	2,122	10,811,713.15
Shtime	977,090	810,343	166,747	266,448	240,584	25,864	-	192,611.38
Graçanicë	3,043,885	2,070,990	972,895	1,072,956	779,068	293,888	-	1,266,782.58
Dragash	571,040	423,785	147,254	87,239	80,151	7,088	-	154,342.63
Prizren	12,203,073	10,332,531	1,670,542	1,205,617	1,204,286	1,331	-	1,671,873.59
Rahovec	2,622,246	2,001,459	620,787	679,543	678,791	752	-	621,539.62
Suharekë	2,993,778	2,272,150	721,628	805,109	790,367	14,742	10,197	746,566.82
Malishevë	2,557,869	1,456,225	1,101,644	338,744	335,927	2,817	-	1,104,460.98
Mamushë	102,142	84,421	17,720	30,184	30,184	-	-	17,720.08
Deçan	1,069,277	889,768	179,509	320,325	320,320	5	-	179,513.58
Gjakovë	7,069,025	5,083,868	1,985,157	1,145,519	1,010,155	135,365	-	2,120,521.85
Istog	2,648,172	1,481,289	1,166,883	950,353	943,265	7,088	-	1,173,970.29
Klinë	2,052,202	1,326,325	725,877	624,855	525,589	99,266	-	825,142.11
Pejë	7,795,980	4,283,640	3,512,340	1,420,328	1,058,646	361,681	3,000.00	3,877,021.66
Junik	166,490	117,546	48,943	108,485	107,008	1,476	-	50,419.96
Leposaviq	134,320	28,450	105,869	152,126	-	152,126	-	257,995.23
Mitrovicë	3,985,737	2,906,773	1,078,965	867,555	716,926	150,629	-	1,229,593.36
Skenderaj	1,767,298	1,514,420	252,878	194,931	193,700	1,230	-	254,108.24
Vushtri	4,460,654	3,886,481	574,173	1,007,972	1,006,740	1,232	-	575,404.93
Zubin Potok	126,775	-	126,775	-	-	-	72,595	199,369.44
Zveçan	114,008	52,032	61,975	72,019	58,065	13,954	-	75,929.15
Mitrovica Veriore	206,017	106,050	99,967	12,514	9,922	2,592	-	102,559.31
Gjilan	6,280,036	4,462,697	1,817,339	2,116,870	1,885,249	231,621	2,573,465	4,622,424.74
Kacanik	1,038,094	726,520	311,573	1,033,041	914,079	118,962	-	430,535.34
Kamenicë	1,233,025	947,810	285,216	408,555	390,343	18,212	-	303,428.05
Novo Bërd	601,393	352,361	249,032	214,749	182,789	31,960	-	280,991.91
Shtërpçë	383,904	301,961	81,943	297,111	140,723	156,388	-	238,331.13
Ferizaj	10,484,566	7,971,534	2,513,031	2,277,102	2,276,046	1,056	142	2,514,228.80
Viti	1,567,206	1,268,404	298,802	230,521	225,467	5,054	-	303,855.75
Partesh	243,427	203,093	40,335	37,147	34,205	2,942	-	43,276.46
Hani i Elezit	1,268,413	707,343	561,069	170,772	151,657	19,115	-	580,184.23
Kliokot	146,440	116,630	29,810	99,247	77,350	21,897	-	51,706.80
Ranilug	162,814	65,103	97,711	170,492	65,072	105,419	-	203,130.06
Gjithsej	146,852,958	106,974,669	39,878,290	54,871,318	51,795,861	3,075,457	2,661,520	45,615,266.18



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021467-3/26 dt. 29.04.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 8, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (GZ Nr. 04/2026, 02.03 2026,); neneve 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 29.04.2026, pasi shqyrtoi Kërkesën Nr.02-400/03-018797/26 dt. 08.04.2025 Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe viteve paraprahe në buxhetin e vitit 2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0018345-3/26, dt. 20.04.2026), sjell këtë:

VENDIM

Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprahe në buxhetin e vitit 2026

1. MIRATOHET Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprahe në buxhetin e vitit 2026.
2. Shuma e mjeteve të bartura sipas pikës 1. të këtij Vendimi është 1.229,563.36 €.
3. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 934,563.36 € destinohet për kategoritë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime, në programet/nënprogramet:
 - 3.1 Zhvillimi Ekonomik (48022) në vlerë 804,563.36 €;
 - 3.2 Inspektime (16643) në vlerë 80,000.00 €;
 - 3.3 Menaxhimi i katastrofave natyrore (18466) në vlerë 30,000.00 €;
 - 3.4 Zyra e kuvendit(16922) në vlerë 20,000.00 €;
4. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 295,000.00 € destinohet për kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, në nënprogramet:
 - 5.1 Administrata e përgjithshme (16322), në vlerë 75,000.00 €.
 - 5.2 Shërbimet Kulturore (85022), në vlerë 80,000.00 €.
 - 5.3 Bujqësia (47022), në vlerë 90,000.00 €.
 - 5.4 Shërbimet Sociale (75606), në vlerë 50,000.00 € dhe
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Të gjitha drejtorive



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	26.06.2026
REFERENCË:	NR. 02-060/01-0034085/26-2
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës Anëtarët e Kuvendit të Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga konsultimi me publikun për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029



Hyrje

Duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 61, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenet 25 dhe 26 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 19 dhe nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Safet Kamberi, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim, ka shpallur konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, i cili është mbajtur më 19.06.2026 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ecuria e procesit

Sekretaria e Kuvendit, në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, ka publikuar njoftimin për konsultim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, në ueb-faqen zyrtare të Komunës <https://mitroviccejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftim-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-2027-2029-ne-konsultim-publik.pdf> dhe në rrjetet sociale të Komunës, tetë ditë para mbajtjes së takimit.

Njoftimi për konsultim publik është shpallur brenda afatit të paraparë ligjor, me qëllim të sigurimit të informimit të plotë dhe të duhur të palëve të interesuara. Përmes njoftimit,

qytetarët dhe palët e tjera të interesuara janë informuar për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik.

Njoftimit i është bashkëngjitur dokumenti i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029, i cili ka qenë objekt i konsultimit publik, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve dhe sugjerimeve.

Metodat e konsultimit

Metoda e konsultimit	Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve
Konsultime me shkrim / në mënyrë elektronike	15 ditë	0
Publikimi në ueb-faqen zyrtare të Komunës	8 ditë para mbajtjes së takimit	0

Pjesëmarrja në takim

Në takim morën pjesë gjithsej 15 pjesëmarrës, prej tyre 6 gra dhe 9 burra.

Në konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029 morën pjesë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Safet Kamberi, përfaqësues të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Sekretaria e Kuvendit, drejtorë të drejtorive komunale, Zyra për Informim, si dhe qytetarë të Komunës së Mitrovicës së Jugut, të evidentuar në listën e pjesëmarrjes, e cila i bashkëngjitet këtij raporti.

Takimi është mbajtur më 19 qershor 2026 në sallën e Kuvendit Komunal. Qëllimi i diskutimit ishte prezantimi i prioriteteve buxhetore komunale dhe mbledhja e propozimeve nga qytetarët, përfaqësuesit e lagjeve, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit.

Diskutimet, pyetjet dhe përgjigjet

Pjesëmarrësi	Pyetja / Komenti	Përgjigja
Xhenis Beqiri dhe Bukuriye Brezhnica	A është paraparë në Kornizën Afatmesme Buxhetore mbështetja e shërbimeve sociale për OJQ-të e licencuara që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut? Nëse po, a do të realizohet kjo mbështetje në formë të subvencionimit përmes projekteve apo përmes kontraktimit të shërbimeve, bazuar në Planin Komunal të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2025–2027?	Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi, sqaroi se kjo çështje nuk mund të përfshihet në këtë fazë në Kornizën Afatmesme Buxhetore. Megjithatë, qytetarët dhe organizatat mund të paraqesin propozimet dhe kërkesat e tyre gjatë procesit të hartimit të buxhetit komunal, i cili zakonisht zhvillohet gjatë muajve korrik dhe gusht. Propozimet e paraqitura do të shqyrtohen në përputhje me

prioritetet dhe mundësitë
buxhetore të komunës.

Nuk ka pasur pjesëmarrës të tjerë në diskutim.

Vlen të theksohet se Sekretaria e Kuvendit nuk ka pranuar asnjë vërejtje, koment apo sugjerim me shkrim ose në forma të tjera gjatë periudhës së konsultimit publik, në përputhje me afatet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Përfundim

Konsultimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029 është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative në fuqi. Gjatë takimit është paraqitur një pyetje nga pjesëmarrësit lidhur me mbështetjen e OJQ-ve që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, për të cilën është ofruar sqarimi përkatës nga Kryesuesi i Kuvendit. Nuk janë pranuar komente apo propozime me shkrim gjatë periudhës së konsultimit publik.

Shtojcë

Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica- Municipality of Mitrovica

DATË/A:	20.05.2026
REFERENC-Ë:	01-400/01-0029109/26
PËR/ZA/TO:	Faton PEÇI – Kryetar i Komunës
KOPJE :	Drejtorët e Drejtorive Komunale
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Zenel ÇITAKU – Shef i Sektorit për Buxhet dhe Financa OZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja e Brendshme Buxhetore 2027/01



Të nderuar,

Bashkëngjitur gjeni Qarkoren e Brendshme Buxhetore 2027/01 të Komunës së Mitrovicës së Jugut, e hartuar në bazë të Qarkores Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave, si dhe Qarkoren Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave për referencë gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore.

Kjo qarkore paraqet totalin e financimit komunal për vitin 2027 përmes granteve qeveritare, si dhe projeksionet financiare për vitet 2028–2029, duke shërbyer si bazë për planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit komunal në përputhje me prioritetet dhe nevojat institucionale të Komunës.

Përmes këtij dokumenti synohet sigurimi i një procesi të koordinuar, transparent dhe të bazuar në prioritetet strategjike të Komunës, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Luteni që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore të respektohen udhëzimet, kriteret dhe afatet e përcaktuara në këtë qarkore.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KOMUNA E MITROVICËS
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of South Mitrovica



Qarkorja e Brendshme Buxhetore

2027/01



Maj 2026

Permbajtja

Përgatitja e Buxhetit Komunal për vitin 2027 dhe projeksionet për 2028–2029.....	3
1. Qëllimi i Qarkores.....	3
2. Konteksti	3
3. Udhëzime për përgatitjen e kërkesave buxhetore	3
4. Kriteret themelore për propozimet buxhetore	3
5. Dokumentacioni i nevojshëm për dorëzim	4
6. Afatet dhe përgjegjësitë	4
7. Konsultimet dhe harmonizimi i kërkesave	4
Projeksioni i të hyrave vetanake sipas Qarkores Buxhetore 2027/01	5
Totali i financimit komunal sipas Qarkores Buxhetore 2027/ 01	6
Tabela krahasuese e buxhetit të vitit 2027 me financimet e buxhetit për vitin 2026.....	6
Kalendari kohor i procesit të buxhetit komunal.....	7

Përgatitja e Buxhetit Komunal për vitin 2027 dhe projeksionet për 2028–2029

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe plotësim-ndryshimeve të tij, dhe në përputhje me kalendarin dhe udhëzimet e Qarkores Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave, lëshohet kjo Qarkore e Brendshme për orientimin e procesit të planifikimit buxhetor komunal.

1. Qëllimi i Qarkores

Kjo qarkore ka për qëllim të njoftojë të gjitha njësitë organizative të Komunës së Mitrovicës për kufijtë buxhetorë të përcaktuar për periudhën e planifikimit buxhetor 2027, si dhe projeksionet për vitet 2028–2029. Përmes saj sigurohet shpërndarja e informacionit mbi kornizën fiskale brenda së cilës duhet të zhvillohet procesi i planifikimit buxhetor.

Qarkorja synon të orientojë njësitë komunale në përgatitjen e kërkesave buxhetore në përputhje me kufijtë e miratuar, prioritetet zhvillimore të komunës dhe udhëzimet e Qarkores Buxhetore 2027/01. Ajo shërben si bazë për disiplinimin e procesit të planifikimit dhe për sigurimin e një shpërndarjeje sa më efikase të burimeve publike.

2. Konteksti

Procesi i hartimit të buxhetit duhet të reflektojë prioritetet strategjike të Komunës, duke përfshirë:

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike;
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies;
- Investimet në infrastrukturë dhe arsim;
- Digjitalizimin e shërbimeve dhe avancimin e barazisë gjinore.

3. Udhëzime për përgatitjen e kërkesave buxhetore

Drejtoritë komunale obligohen që të dorëzojnë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa:

- Parashikimet e realizimit të buxhetit për vitin 2027, së bashku me arsyetimet për devijimet eventuale;
- Kërkesat buxhetore të detajuara sipas programeve dhe projekteve;
- Projeksionet buxhetore për vitet 2028–2029.

4. Kriteret themelore për propozimet buxhetore

Në vlerësimin e kërkesave buxhetore do të merren parasysh:

- Projektet në përputhje me prioritetet komunale dhe qendrore;
- Projektet me obligime kontraktuale ekzistuese;
- Projektet e financuara nga IPA dhe programet e integritimit evropian;
- Projektet me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin lokal;
- Integrimi i buxhetimit gjinor dhe qasja e bazuar në performancë.

5. Dokumentacioni i nevojshëm për dorëzim

- Tabelat përmbledhëse buxhetore për periudhën 2027–2029;
- Formularët SZHMB dhe PIP;
- Tabelat e buxhetimit gjinor dhe indikatorët e performancës;
- Arsyetimi i detajuar për çdo kërkesë buxhetore.

6. Afatet dhe përgjegjësitë

- Të gjitha drejtoritë janë të obliguara të respektojnë afatet dhe të caktojnë persona përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit buxhetor;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të koordinojë procesin dhe do të ofrojë mbështetje teknike gjatë gjithë fazës së përgatitjes.

7. Konsultimet dhe harmonizimi i kërkesave

Pas dorëzimit të kërkesave, do të organizohen konsultime të brendshme për harmonizimin e propozimeve dhe finalizimin e Kornizës Afatmesme komunale 2027-2029 si dhe projekt-buxhetit komunal.

Granti i Përgjithshëm për vitin 2027 do të jetë në shumën prej 14,529,076.00 €. Ky grant shpenzohet nga të gjitha Programet dhe Nën-programet Komunale ku përfshihen të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël, poashtu edhe përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejtë rezultateve dhe performancës.

Granti Specifik për Arsim Parauniversitar bazohet në sistem të hapur të financimit duke marrë parasysh kriteret në formulën e financimit të arsimit para-universitar, andaj në vitin 2027 për Komunën e Mitrovicës arrin vlerën 11,682,190.00 €.

Granti Specifik për Shëndetësi Primare, bazohet në sistem të hapur të financimit duke marrë parasysh kriteret në formulën e financimit të Shëndetësisë, andaj në vitin 2027 për Komunën e Mitrovicës arrin vlerën 3,243,374.00 €.

Financimi për Shërbime Rezidenciale, Komuna e Mitrovicës për vitin **2027**, do të përfitoj 230,000.00 Euro. Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve (SHEMF) në vlerë 152,500.00 €. Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve i është ndarë Buxheti si në vijim: Paga dhe shtesa 52,500.00 €, Mallra dhe Shërbime 45,000.00 €, Shpenzime Komunale 5,000.00 € dhe Shpenzime Kapitale 50,000.00 €.

Financimi për Teatrot, Sipas Qarkores 2027/01 Komuna e Mitrovicës ka përfituar nga Komisioni i Grandeve shumën prej 295,346.00 €, në kategorinë ekonomike të Pagave dhe shtesave 254,170.00 € dhe 41,176.00 € në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve.

Projeksioni për Të Hyrat Vetanake 2027 është në vlerën prej 3,912,644.00 Euro.

Projeksioni i të hyrave vetanake sipas Qarkores Buxhetore 2027/01

Nr.	Përshkrimi	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029
1	Tatimi në pronë	1,089,704.00	1,100,601.00	1,106,104.00
2	Tatimi në tokë	264,665.00	265,988.00	267,318.00
	Totali i të hyrave tatimore	1,354,369.00	1,366,589.00	1,373,422.00
	Totali i të hyrave jo tatimore	2,558,275.00	2,685,677.00	2,909,394.00
Total		3,912,644.00	4,052,266.00	4,282,816.00

Tabela 1

Sqarim: Qarkorja Buxhetore 2027/01 përcakton shumën e përgjithshme të të hyrave vetanake jotatimore për Komunën, ndërsa planifikimi dhe shpërndarja e tyre në kodet përkatëse të të hyrave bëhet nga komuna, varësisht nga lloji i shërbimeve të ofruara dhe burimet e gjenerimit të këtyre të hyrave.

Totali i financimit komunal sipas Qarkores Buxhetore 2027/ 01

Totali i Financimit komunal sipas Qarkores Buxhetore 2027/01				
Nr.	Përshkrimi	2027	2028	2029
1	Granti i Përgjithshëm	14,529,076.00	15,186,826.00	16,383,779.00
2	Granti specifik për Arsim	11,682,190.00	12,032,656.00	12,393,636.00
3	Granti specifik për shëndetsi	3,243,374.00	3,340,675.00	3,440,895.00
4	Financimi për Teatro	295,346.00	311,590.00	328,728.00
5	Financimi për Shërbime Rezidenciale	230,000.00	200,000.00	200,000.00
6	Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve (SHEMF)	152,500.00	215,000.00	215,000.00
	Gjithsej Granti	30,132,486.00	31,286,747.00	32,962,038.00
7	Të Hyrat Vetanake	3,912,644.00	4,052,266.00	4,282,816.00
	Totali i Buxhetit	34,045,130.00	35,339,013.00	37,244,854.00

Tabela 2

Tabela krahasuese e buxhetit të vitit 2027 me financimet e buxhetit për vitin 2026

Totali i Financimit komunal sipas Qarkores Buxhetore 2027/01					
Nr.	Përshkrimi	2027	2026	Ndryshimi	Index %
1	Granti i Përgjithshëm	14,529,076.00	12,898,307.00	1,630,769.00	13%
2	Granti specifik për Arsim	11,682,190.00	11,506,885.00	175,305.00	2%
3	Granti specifik për shëndetsi	3,243,374.00	3,651,356.00	(407,982.00)	-11%
4	Financimi për Teatro	295,346.00	279,708.00	15,638.00	6%
5	Financimi për Shërbime Rezidenciale	230,000.00	382,500.00	(152,500.00)	-40%
6	Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve (SHEMF)	152,500.00		152,500.00	#DIV/0!
	Gjithsej Granti	30,132,486.00	28,718,756.00	1,413,730.00	5%
7	Të Hyrat Vetanake	3,912,644.00	3,700,000.00	212,644.00	6%
Totali i Buxhetit		34,045,130.00	32,418,756.00	1,626,374.00	5%

Tabela 3

Kalendari kohor i procesit të buxhetit komunal

- 30 Qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,
- 30 Shtator: Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitin 2027-2029 nga Kuvendi Komunal,
- 30 Shtator: pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, dokumentet si në vijim:
- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2027-2029, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
- Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2027-2029 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.1.B - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2026 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2027-2028 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes, Ministria e Financave, Departamenti i Buxhetit,
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabelat e Buxhetimit sipas performancës.
 - Buxhetimi gjinor.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCËVE-MINISTARSTVO ZA FINANSIJE-MINISTRY OF FINANCE	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	06/4/40 Prot. Prot. No. 987/2026
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	15, 05, 26
PRISHTINË/PRISTINA/PRISHTINA	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije/ Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	15.05.2026
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Sekretarët e Përgjithshëm, Kryeshefat e Agjencive, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2027/01

Të nderuar,

Me lejon t'ju shpreh falënderimin tim për kontributin tuaj të çmuar në hartimin e projeksioneve buxhetore për periudhën 2027–2029, të cilat përbëjnë bazën për përgatitjen e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027.

Në vijim, ju përcjellim Qarkoren Buxhetore 2027/01, e cila përmban kufijtë fillestarë buxhetorë për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror, si dhe kufijtë buxhetorë për nivelin komunal për periudhën 2027–2029.

Ministria e Financave mbetet në dispozicionin tuaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2027.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër i Financave



Qarkorja Buxhetore 2027/01

1. Qëllimi

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës të lëshojë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri lëshon Qarkoren Buxhetore 2027/01, e cila përmban udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2027, si dhe vlerësimet për vitet 2028 dhe 2029. Kjo qarkore përfshin gjithashtu kalendarin kohor indikativ për procesin buxhetor dhe kufijtë fillestarë buxhetorë për vitin 2027, përkatësisht vlerësimet për vitet 2028-2029 për secilën organizatë buxhetore.

Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të lëshohen edhe qarkore të tjera plotësuese deri në finalizimin e plotë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027 dhe vlerësimeve për vitet pasuese.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2027-2029

Planifikimi i buxhetit për vitin 2027 mbështet në prioritetet qeveritare dhe kornizën makro-fiskale. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimet sektoriale buxhetore dhe prioritetet e përcaktuara.

